



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

### Procesverbal

nga takimi publik me qytetarë i mbajtur më 30 qershor 2023

### Takimi filloi në orën 10.10

Takimin publik e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës. Në takim ishin të pranishëm një numër i qytetarëve (24 pjesëmarrës); Nënkryetarja e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës, përfaqësues të OJQ-ve dhe mediat.

### Tema:

**Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve tjera të parapara në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023, projektet dhe aktivitetet që janë në proces, si dhe ato të planifikuara për realizim**

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, qytetarë të nderuar ju përshëndes të gjithëve dhe ju falënderoj që keni ndarë kohën që bashkërisht të bëjmë shpalosjen e punës gjashtë mujore të ekzekutivit të Komunës së Podujevës. Sigurisht që ky raport është konform rregullativave ligjore të cilat kërkojnë të realizohen takime të hapura me qytetarë, me qëllim që të diskutojmë për projektet të cilat janë duke u realizuar, por pse jo edhe kërkesat eventuale që dalin nga takimi të cilat do të diskutohen dhe trajtohen. Atëherë të fillojmë sipas Drejtorive;

### Drejtoria e Administratës

Gatë muajt qershor 2023 kanë filluar takimet publike me qëllim të zgjedhjes së këshillave të fshatrave.

Vendosja e GPS-ve në vetura zyrtare.

Lidhja e kontratës për shtimin e shërbimit "certifikata e pronës" në e-kioska me qëllim të shtimit të shërbimeve në mënyrë elektronike.

Në sektorin e gjendjes civile në zyrat dhe e-Kioska janë lëshuar gjithsej 42.426 certifikata të ndryshme.

Dërgimi i kërkesës në AQP për blerjen e veturave të reja zyrtare me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve për qytetarët.

Fillimi i procedurave të prokurimit për rregullimin e oborrit në objektin e ri të Komunës për një ambient të gjelbër.

Gjatë kësaj periudhe janë arkivuar mbi 3500 lënde në arkivin e komunës, janë lëshuar 715 vendime, janë përkthyer 132 dokumente të ndryshme si lajme, rregullore, konkurse etj.

### Drejtoria e Buxhetit dhe Financave

Është planifikuar Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026 e Komunës së Podujevës, kjo kornizë<sup>SEP</sup> buxhetore është me buxhetin më të madh në historinë e Komunës së Podujevës, ku për vitin 2024 planifikohet buxhet në vlerë 31,423,020.00 € ndërsa në vitin 2026 arrin shumën prej 34,664,197.00 €.

Janë realizuar të hyra vetanake në periudhën Janar-Qershor afër 900.000 €. Është bërë bartja e të hyrave vetanake në vlerë 778,057.36 € . Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar në sistemin e tatimit në pronë afër 600 objekte.

### **Drejtoria e Arsimit**

Furnizimi i të gjitha shkollave me pajisje kompjuterike, për këtë projekt janë të planifikuara 200,000 €.

Furnizimi me Kabinete Muzikore, për këtë projekt janë të planifikuara 10,000 €. Furnizimi me rekuizita sportive, është nënshkruar kontrata për këtë projekt në vlerë 15,279 €. Në fazën e realizimit të projektit në bashkëfinancim me IOM në fushën e edukimit fillor janë furnizuar me kabinete shkolla e Orllanit dhe Sfeçlës.

Furnizimi me tabela digjitale, për këtë projekt janë të planifikuara 300,000€. Furnizimi me kabinete Gjeografi, Histori, Matematikë, është nënshkruar kontrata në vlerë 48,681 €.

Instalimi i kamerave në shkolla, për këtë projekt është nënshkruar kontrata, planifikohet të investohet në 9 objekte shkollore.

Furnizimi për inventarë në çerdhe, për këtë projekt janë të planifikuar 50,000 €.

Është bërë inaugurimi i Qendrës së parë të Karrierës në Podujeve, në të cilën qendër të rinjtë tanë do të mbajnë trajnime dhe do të këshillohen nga trajnerë kompetentë duke i orientuar ata për tregun e punës dhe mundësitë që ofrohen në sektorë të ndryshëm për të zhvilluar një karriere të suksesshme. Qëllimi i themelimit të Qendrës së Karrierës është identifikimi i talenteve dhe potencialeve si dhe zhvillimi i tyre.

Janë ndarë bursa për 281 student në vlere prej 98,750 €.

Janë inauguruar masat e eficiences së energjisë - projekt i realizuar në bashkëfinancim me <sup>[1]</sup>Qeverise së Kosovës, BE-së dhe Bankës Botërore në vlere 730,000 €.

Janë në fazën e vlerësimit projektet e infrastrukturës shkollore, ku janë të planifikuara 500,000 €.

Janë duke u vlerësuar nga komisioni ofertat lidhur me ndërtimin e SHME "Isa Boletini", për këtë projekt janë të planifikuara 2,000,000 €.

Kanë filluar punimet në ndërtimin e shkollës fillore në Dumosh në vlerë 562,000 €. Po ndërtohet salla e edukatës fizike në shkollën fillore Enver Maloku, punimet janë në fazën finale, vlere e projektit 215,488.48 €.

Është në ndërtim e sipër shkolla fillore në fshatin Obrancë, projekt në vlerë prej 497,715.63 €.

Po ndërtohet salla e edukatës fizike në shkollën fillore Naim Frashëri në vlerë prej 303,773.08 €.

Fillimi i punimeve në çerdhën më të madhe publike me hapësirë prej 1400 m<sup>2</sup> - vlere e projektit 687.000 €.

Ndërtimi i liftit, pjerrinave dhe renovimi i banjave për nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën <sup>[1]</sup>"Shaban Shala" në Podujeve të financuar nga Bashkimi Evropian që kap vlerën 150,000 €.

Renovimi i tërësishëm i brendshëm i pjesës së vjetër të objektit të shkollës "Shaban Shala" në Podujevë, financuar nga bashkimi Evropian që kap vlerën 350.000 €.

### **Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

Po vazhdon ndërtimi i Urgjencës së qytetit, projekt ky në bashkëfinancim me organizatën e Katarit, vlere e projektit 1.7 milionë €, ku komuna participon me 600.000 €.

Furnizime me barna dhe reagensa me vlerë 413,706 €.

Servisimi i pajisjeve mjekësore me vlerë 35,000 €.

Furnizim me dokumentacion mjekësor me vlerë 55,000 €.

Furnizim me material, higjienik me vlere 30,000 €.

Furnizim me pelet me vlere 65,000 €.

Blerja e autoambulancave në vlerë 150,000 €.

Renovimi i objekteve shëndetësore në vlere 50,000 €

Ndërtimi qendres rezidenciale për të moshuar në bashkëpunim me shoqatën "Jetimat e Ballkanit" në vlerë 2.5 milion €, ndërsa komuna do të participojë me 530,000 €.

Furnizim me naftë për ngrohje në vlerë 25,000 €.

Furnizim me naftë për vetura (shërbimi shtëpiak shëndetësor) në vlerë 150,000 €

Furnizimi dhe Servisimi i aparateve kundër zjarrit në vlerë 5,000 €

Furnizim me oksigjen në vlerë 7,000 €.

### **Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

Gjithsej në periudhën janar-qershor 2023 janë proceduar 14 kontrata për asfaltim në territorin e komunës, dhe atë: Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Batllavë, Gërdoc, Kaçibeg; Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumnicë; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Sylevicë, Tërnavicë; Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bellopojë; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Godishnjak, Lluzhan dhe Shakovicë; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Tërnavë dhe Halabak; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Gllamnik dhe Sibofc; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Lladoc dhe Shajkoc; Asfaltimi i rrugëve në fshatin Orllan me rrethinë; Asfaltimi i rrugëve në Qytet, i ndarë në 3 Loto; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Letanc, Përan dhe Llapashticë; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Lupç dhe Majac; Asfaltimi i disa rrugëve në fshatrat: Pakashticë, Zakut, Kërpimeh dhe Metehi; Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Xhemail Mustafa"; Gjithsej 26.886 km

Projektet dy vjeçare 2022/23:

Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gllamnik; Asfaltimi i rrugëve në fshatin Llapashticë; Asfaltimi i rrugëve në Qytet; Asfaltimi i rrugëve lidhëse në fshatrat Llaushë - Doberdol, Buricë - Konushë dhe Dumosh – Sfeqël; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Revuq-Bajqinë; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Lluga-Konushefc; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Bradash-Dobratin; Asfaltimi i rrugëve në fshatin Letanc - Memorandumet me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës për vitin 2023; Sanimi dhe rehabilitimi i rrugës së dëmtuar nga vërshimet në fshatin Pakashticë në vlerë prej 154,000.00 €; Zgjerimi, sanimi dhe riasfaltimi i rrugës kryesore në Shamalluk në vlerë prej 186,500.00 €; Ndërtimi i rrugës Turuçicë-Herticë në vlerë prej 350,000.00 €.

Hartimi i projekteve: si Pishina Gjysmë Olimpikë, projektet në asfaltim të rrugëve, projektet në ndërtim të rrugëve me kubëza, projektet e kanalizimit fekal në fshatra të ndryshme Meremetimi i objekteve banesore në qytet – vlera e projektit rreth 300 mijë €; Ekzaminimet e materialeve ndërtimore; Mirëmbajtja e fontanave në sheshin e qytetit; Rregullimi i lodrave në park; Ndërtimi i hapësirave të gjelbra.

### **Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë**

Gjatë periudhës 6 mujore ka pranuar 5240 kërkesa, nga të cilat janë aprovuar 5203, të anuluar janë 6 kërkesa dhe 31 janë në shqyrtim e sipër. Përndryshe 99.3% të kërkesave janë trajtuar.

Nga sektori i kadastrit dhe gjeodezisë janë trajtuar 1254 kërkesa, ku janë aprovuar gjithsej 1239 apo 98.8%.

Krahas kësaj gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi ka përgatitur të gjitha dokumentet e nevojshme për shpronësimin e tokave nga AKP në pronësi të komunës.

### **Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit**

Subvencionimi i projekteve në fushat e Kulturës dhe Rinisë...21,700 €; Subvencionimi i projekteve Individuale për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike... 10,000 €.

Subvencionimi i projekteve teatrore... 39,000 €.

#### **Sektori për Kulturë dhe Rini:**

Është nënshkruar kontrata për shërbime, për shënimin e aktiviteteve kulturore dhe përcjelljen mediatike të punëve të Komunës së Podujevës në vlerë 43,640 €.

#### *Biblioteka e Qytetit:*

Është nënshkruar kontrata për furnizim me libra për Bibliotekën e Qytetit në vlerë 19,220 €.

Është përruruar Biblioteka e re e Qytetit e cila përbëhet nga katër kënde të furnizuara me libra. Biblioteka posedon edhe sallën kryesore për lexim me kapacitet mbi 50 lexues, sallën për punë në grupe dhe sallën e fëmijëve.

#### *Teatri i Qytetit:*

Janë dhënë dy premiera, një për fëmijë dhe një për të rritur.

Në gjashtë muajt e fundit janë dhënë gjithsej 19 repriza të shfaqjeve.

Po ashtu janë prezantuar gjashtë shfaqje mysafire, kurse Teatri Avdush Hasani me shfaqjet e tij e ka prezantuar Komunën në katër teatro në Kosovë dhe Luginë të Preshevës.

#### *Aktivitetet Kulturore*

Janë organizuar aktivitete për shënimin e datave të rëndësishme, si Përvjetori i Pavarësisë së Kosovës, 5 Maji Dita e Dëshmorëve, 19 Qershori Dita e Çlirimit të Komunës, ku janë organizuar koncerte dhe është organizuar dita e fëmijëve.

#### *Galeria e artëve*

Në Galerinë e Artëve janë hapur 5 ekspozita si dhe janë organizuar 3 promovime të librave.

#### **Sektori i sportit:**

Janë organizuar turne të ndryshme në futboll, basketboll dhe volejboll për shënimin e ngjarjeve me rëndësi për komunën dhe vendin.

Është zhvilluar aktiviteti "Me Bicikleta n'Pranverë".

Garat shkollore sportive komunale në Futsal meshkujt dhe femrat.

#### **Investimet kapitale:**

Është inicuar procedura për ndërtimin e infrastrukturës sportive në vlerë **450.000€**, e cila përfshin: Fusha sportive në futboll; Fushën e tenisit; Fusha e basketbollit në qytet; Fusha e volejbollit në rërë; Zgjerimi i hapësirave sportive në palestër; Përfundimin e projektit të fushës në Peran dhe përfundimin e projekteve që kanë mbetur në gjysmë, me vendosjen e rrethojave dhe ndriçimit. Është në fazën finale të vlerësimit.

Kemi inicuar procedurën për ndërtimin e shtatores së Adem Demaçit në vlerë 60,000 €. Është në fazën finale të vlerësimit.

Është caktuar lokacioni i ri për ndërtimin e Qendrës Multifunktionale, punimet do të fillojnë në muajin Korrik.

Është caktuar lokacioni i ri për ndërtimin e Palestrës së Sporteve.

Është hartuar projekti zbatues për ndërtimin e pishinës Gjysmë Olimpikë

#### **Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim**

Gjatë kësaj periudhe janë kryer një mori punëve dhe aktiviteteve, si: Ndërtimi i trotuareve në qytet - deri tash janë ndërtuar 3580m dhe është duke vazhduar puna në terren; Zgjerimi i shtratit të lumenjve dhe përroskave (gabion), kanë filluar punimet në vendosjen e pikave gjeodezike, janë planifikuar 700 m rregullim dhe së shpejti fillojnë punimet; Ndërtimi i stacionit të autobusëve - punimet po zhvillohen dhe projekti planifikohet të përmbyllet vitin e ardhshëm; Riparimi i rrugëve të asfaltuara - janë mbyllur gropa në hapësirë prej 7045 m<sup>2</sup>; Rregullimi i rrugëve me zhavorr - gatë kësaj kohe janë duke u zhvilluar punimet në rrugët

Popovë-Segash & Ekrem Dili në Orllan; Mirëmbajtja dhe pastrimi i lumenjve - Janë pastruar Lumi Kaganoll 200 m dhe Lumi i Bradashit, 2500 m - vazhdon edhe me tutje tek lumenjtë e tjerë dhe në vendbanime të tjera.

Trajtimi i qenve endacak, ku deri me tani janë trajtuar 190 qen.

Gjatë kësaj periudhe është bërë mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, po ashtu mirëmbajtja e infrastrukturës publike (kanalizim fekal dhe atmosferik); Largimi i deponive ilegale, ku gjatë këtij viti janë larguar 54 deponi ilegale; Vendosi dhe dislokimi i kamerave - po mirëmbahen kamerat e sigurisë dhe po behet zgjerimi i zonës për të mbuluar hapësira të reja me kamera të sigurisë; Mirëmbajtja e ndriçimit publik - janë rregulluar të gjitha dëmtimet e trupave ndriçues, tash është iniciuar edhe procedura e re për mirëmbajtjen e vazhdueshme të ndriçimit.

Sa i përket intervenimeve të zjarrfikësve, për 6 muaj janë bërë gjithsej 179 intervenime.

### **Drejtoria e Inspeksionit**

Drejtoria e Inspeksionit gjatë periudhës gjashtë mujore ka kryer veprime dhe ka ndërmarrë masat si vijon:

Inspektime në fushën e ambientit; Inspektime të ndryshme sa i përket keqpërdorimit të ujit të pijes nga qytetarët e papërgjegjshëm; Inspektime në furrat e bukës, markete, pompa të derivateve, dyqane etj; Aksione të shpeshta ndaj taksistëve ilegal; Inspektime në shërbime publike - janë kryer punë sa i përket lirimit të hapësirave publike që janë shfrytëzuar pa pëlqime paraprake, janë bërë inspektime të cilat lidhen me transportin rrugor dhe orarin e lëvizjes së tyre si dhe janë bërë evidentime të cilat lidhen me fushën e ndërtimitarisë.

Janë bërë rrënime në sektorin e ndërtimit në objektet pa leje.

### **Drejtoria e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural**

Gjatë kësaj periudhe është bërë subvencionimi i një numëri të projekteve në bujqësi, dhe atë: "Përkrahja e fermerëve me fidanë të mjedrës", ku është bërë përzgjedhja e 37 apikuesve për implementimin e projektit, ndërsa tani projekti është në fazën e realizimit nga ana e fermerëve si dhe kompletimit të dokumentacionit me qëllim të realizimit të mbështetjes nga ana e komunës. Vlera maksimale me të cilën do të mbështetet çdo fermer përfitues është 1000 €, ndërsa pagesa do të bëhet pas konstatimit se janë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara, vlera e projektit është 40,000 €.

Te projekti "Përkrahja e fermerëve me feferona" është bërë përzgjedhja e 13 aplikuesve për implementimin e projektit, tani projekti është në fazën e realizimit nga ana e fermerëve si dhe kompletimit të dokumentacionit me qëllim të realizimit të mbështetjes nga ana e komunës. Vlera maksimale me të cilën do të mbështetet çdo fermer përfitues është 500 €, ndërsa pagesa do të bëhet pas konstatimit se janë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara.

Te projekti "Furnizimi dhe montimi i serrave për fermere", është bërë përzgjedhja e 45 fermerëve, ndërsa tani projekti është në fazën e realizimit. Fermerët përfitues këtë vit janë përkrahur me sera në sipërfaqe prej 300m<sup>2</sup> për serë, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës se tyre dhe duke krijuar kushte për gjenerim të të hyrave me të mëdha të tyre dhe vetëpunësim nga aktivitetet e tyre, vlera e projektit është 257142 €.

Te projekti-Furnizimi me mekanizëm bujqësor është bërë përzgjedhja e 75 fermerëve përfitues të cilët do të përkrahen me mekanizëm bujqësor përkatësisht motokultivator 12, vlera e projektit është 142,500 €.

"Furnizimi me mëshqerra" Projekti është në fazën e procedurave të prokurimit, me qëllim të përkrahjes së 130 fermerëve me mëshqerra barrëse, vlera e projektit është 328,571.42 €. Thirrje për Aplikim-për mbështetje përmes Programit për Pagesa Direkte për kulturat dhe aktivitetet bujqësore par vitin 2023- në kuadër të kësaj Thirrje nga MBPZHR janë pranuar gjithsej 2210 aplikacione të fermerëve të cilat janë proceduar për shqyrtim dhe miratim.

Furnizimi me mekanizëm bujqësor për familjet me kushte të rënda ekonomike nga marrëveshja e bashkëpunimit në mes të Komunës së Podujevës dhe organizatës "Qatar Charity"- është bërë shpërndarja e mekanizmit bujqësor përkatësisht moto kultivatorëve për 53 familje përfituese.

"Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës" nga marrëveshja e bashkëpunimit në mes të komunës së Podujevës me organizatën "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK, është bërë përzgjedhja dhe montimi i serrave 176 m<sup>2</sup> për 10 fermerët përfitues, si dhe shpërndarja e 4 paisjeve laktofriz për fermerët përfitues në projektin 3 vjeçar.

Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) për shpërndarjen e 50 frezave për fermerë.

Konfiskimi i masës drunore të qarkulluar në mënyrë ilegale në sasi prej 102.75 m<sup>2</sup> dru zjarri. Ngritja e gjithsej 85 fletëparaqitjeve nga rojet e pyllit për prerësit ilegale.

Pajisja e 39 pronarëve të pyjeve private me leje për prerje të pyllit në prona private. Realizimi i kontratës për shitjen e masës drunore 140 m<sup>3</sup> dru zjarri nga depoja e përkohshme e pylltarisë në fshatin Peran.

### **Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik**

Brenda kësaj periudhe kohore ka kryer punët dhe aktivitetet:

Është miratuar në Kuvend Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 dhe është vlerësuar pozitivisht ligjshmëria nga MAPL; Janë mbështetur 16 biznese me mbulimin e 30% të kostos së blerjeve të makinerisë prodhuese në kuadër të thirrjes publike "Subvencionimi i kapaciteteve prodhuese"; Në kuadër të Turizmit kemi filluar punimet për ndërtimin e shtigjeve të ecjes, vendosjen e ulëseve dhe shportave për mbeturina në fshatrat Zakut-Pakashtice dhe Shakovice-Bellopoj; Në bashkëpunim me EKW janë furnizuar 5 përfitues/e me fidanë të Sherbelës dhe farë të Facelias me qëllim të rritjes së prodhimtarisë së mjaltës; Janë zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme dhe është bërë shpallja publike për PPP "Parkingun nëntokësor"; Është bërë përditësimi i katalogut dhe hartës digjitale - platformës online të parcelave komunale për dhënie në shfrytëzim.

Është bërë Inicimi i procedurës së furnizimit me 100 mjete/pajisje pune për biznese start-up dhe ekzistuese (Rrobaqepësi, Automekanike, Hekrari etj.); Inicimi i procedurave për krijimin e broshurës "Podujeva në figura 2023" me karakteristikat e ndryshme të Podujevës, të paraqitura përmes figurave.

Janë mbajtur sesione informuese dhe asistencë për qytetarë/biznese lidhur me aplikimet në skemat e granteve të publikuara nga MZHR, MINT etj.

Janë pajisur me certifikata të stazhit të punës sipas kërkesave të parashtruara pranë drejtorisë. Një prej punëve të rëndësishme të kësaj Drejtorie është tashmë kemi përmbyllë fazën e shpronësimit të 37.2 ha për fillimin e ndërtimit të infrastrukturës për Parkun industrial të Komunës së Podujevës.

Këto janë në pika të shkurtra të gjitha ato sa kemi arritur t'i përshkruajmë në raport të punës dhe sigurisht që ka edhe një varg punës dhe detyrash të përditshme me të cilat merret Administrata komunale dhe që faktikisht nuk kemi arritur t'i inkorporojmë të gjitha, por mund të ketë edhe ndonjë gjë që mund të kemi harruar nga punët dhe projektet që janë duke u realizuar në Komunën tonë. Ajo që është e rëndësishme edhe në aspektin e prokurimit është se jemi jashtëzakonisht mirë me afatet kohore rreth publikimit të ofertave të ndryshme për realizimin e projekteve të ndryshme dhe meqë jemi në proces të mirë të kryerjes së këtyre punëve, besoj se përmbyllja e këtij viti do të jetë e kënaqshme. Sigurisht që në të gjitha këto projekte kemi edhe telashe, ngapak edhe neglizhenca të kompanive, kemi edhe kompani që po rëndohen pak më shumë me punë dhe nuk po ia arrijnë mjaftueshëm kryerjen e punëve. Jemi në përpjekje të vazhdueshme që ti shtyjmë punët përpara. Jemi të hapur për çdo pyetje, sqarime, kërkesa por edhe vërejtje, andaj jemi në dispozicion të juajin për çdo gjë që ju

intereson. Ajo qe mund te themi eshte se pothuajse nuk ka lokalitet ne territorin e Komunës te cilin nuk e kemi paraparë me ndonjë projekt te caktuar gjate kësaj periudhe kohore, por natyrisht jo te gjitha kanë peshën e njëjtë si projekte, sepse edhe kërkesat nuk janë te ngjashme. Qëllimi është qe te bëjmë një distribuim sa më te mirë te projekteve edhe pse nuk është e lehtë sepse jemi Komuna me territorin më te madh në vend. Fjala është e juaja.

**z. Hazir Latifi** nga fshati Pollatë, shtroi pyetje a ekziston mundësia për punësimin e disa punëtorëve me qëllim të lirim të trotuareve të qytetit, duke filluar prej automjeteve, sepse në masë të madhe po vështirësohet qarkullimi i lirë i qytetarëve dhe çdo moment janë të rrezikuar prej automjeteve. Nënvizoi, në vende tjera marrin uniformë të ngjashme me policinë, janë të komunës dhe të njëjtë i vendosin tiketa në automjete dhe në këtë mënyrë gjobiten dhe kjo qasje ndikon në vetëdijësimin e qytetarëve për respektimin e rregullave sa i përket parkimit të paligjshëm të veturave. Të rrezikuar në masë janë po ashtu nxënësit e shkollave. Kërkesë tjetër është a ka mundësi për angazhimin e dy autobusëve për transport publik duke u shtrirë deri në fshatin Siboc, ku qytetarët mund të paguanin bileta ose javore apo mujore dhe në këtë mënyrë qyteti do të shkarkohej pak nga automjetet.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** theksoi, besoj se dy pyetjet e cekuara nga parafolësi janë me vend. Unë vetëm dua të jap disa shembuj të punës dhe angazhimit tonë gjatë kësaj periudhe kohore. Ne kemi Drejtorinë e Inspeksionit që kryen punët e komunikacionit dhe problemin më të madh e kemi me taksitë ilegale. Kemi mirëkuptim se ata njerëz kanë nevojë për të punuar, por kemi bërë përpjekje me ta për të gjetur mirëkuptim për të mos pengua komunikacionin. Me muaj të tërë kam angazhuar inspektorin e komunikacionit dhe inspektorët tjerë në përgjithësi të hyrja e sheshit të qytetit, pranë lokalit afarist "Pranvera 99" me qëllim të largimit të tyre nga rruga. Kemi një bashkëpunim të mirë me Policinë e Kosovës, por çështja e lirim të trotuareve është ekskluzivisht punë e policisë. Ne nuk kemi polici të Komunës sepse nuk është e paraparë me rregullativa ligjore. Po mundohemi për koordinim maksimal të punëve me policinë, por duhet të kemi mirëkuptim edhe sa i përket Policisë sepse edhe ata po kanë telashe, e para është numri i vogël i policëve, e dyta problemet të cilat janë shfaqë në veri edhe ashtu po absorbojnë një numër të caktuar të policëve ku çdo stacion duhet të participojë me një numër të tyre gjatë kësaj periudhe kohore për të qenë në pjesën veriore të Kosovës. Inspektori i komunikacionit nuk ka të drejtë t'i marr lejen dhe me kërkuar përgjegjësi pse ndalet me automjet në trotuar, nuk mund ti vëjë gjobë apo dënim pse ndalet në trotuar, sepse përveç policisë askush tjetër s'ka të drejtë me u marrë me ata taxi. Sipas policisë njëri prej problemeve është se ka prej tyre që kanë me dhjetëra e dhjetëra tiketa të gjobave të cilat nuk i paguajnë, sepse fjala vjen makina është në emër të dikujt tjetër e gjoba i shqiptohet tjetër kujt, pra krijohet mundësia edhe e regjistrimit të makinave por edhe e ikjes së pagesës së gjobës. Thuhet se ka taksist që ka deri 70 tiketa të gjobave të cilat nuk i paguan dhe ai çdo ditë është aty dhe vetëm përcjellin prezencën tonë, deri sa është policia dhe inspeksioni ik, dhe në momentin që largohen të njëjtë kthehen. Ne nuk jemi duke i penguar në zhvillimin e veprimtarisë, por kërkesa është të mos bllokojnë rrugët dhe trotuaret. Kemi menduar edhe variantet për zgjedhjen e problemit, për vendosjen e pengesave e që nuk është një pamje e mirë, sepse me vendosjen e shtyllave të hekurit apo betonit po e humbet estetika. Atë që kemi planifikuar me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit është që të fillojë procesi i ngritjes së trotuareve me qëllim të lirim të trotuareve, sepse zgjidhje tjetër nuk kemi. Këtë si pilot projekt do ta bëjmë në rrugën kah tregu dhe të shohim se si funksionon por në anën tjetër mendoj se do të na shkaktojë telashe me bizneset, por ne disi duhet ta zgjedhim këtë problem. Më ka ra rasti në Stamboll të shoh trotuare të ngritura ku makina nuk ka mundësi të kalojë në trotuare, andaj mendoj që edhe ne ta aplikojmë këtë, përndryshe trotuaret nuk lirohen. Pra këtë vit do ta provojmë me këtë projekt pilot dhe nëse funksionon duhet gradualisht të gjitha trotuaret e qytetit t'i ngritim, duke lënë një qasje të vogël sa për furnizim të lokaleve afariste. Keni parë në rrugën në drejtim të QKMF-së komplet trotuaret janë të bllokuara nga veturat të

cilat i parkojnë para ordinancave private, ku janë duke u kryer shërbimet shëndetësore. Kjo po ndodhë por është punë ekskluzivisht e Policisë. Ne po mundohemi duke bashkëpunuar shumë ngushtë me Komandantin e Policisë, por punët në terren nuk i kemi mirë, por të shohim se si do të mund të zgjedhim këtë problem, sepse është një brengë e përgjithshme. Kemi angazhuar automjetin merimangë, por siç duket ndodhë tre ditë nuk shkon për marrje të një automjeti. Ajo që është në domenin tonë po mundohemi, por inspeksioni nuk ka të drejtë për shqiptimin e gjobave sepse nuk është e drejtë as detyrë e inspeksionit. Sa i përket çështjes së autobusëve ishte një sugjerim shumë me vend, sikurse jeni në dijeni ne tashmë jemi duke ndërtuar Stacionin e autobusëve dhe me ndërtimin e tij detyrimisht do ta funksionalizojmë trafikun urban. Sigurisht jeni në dijeni se Ndërmarrjen e Stacionit të Autobusëve nuk e kemi gjetur në pikën zero(0) por nën zero(0), me katër pesë punëtorë, pa asnjë autobus dhe nuk jemi në dijeni për gjendjen e autobusëve që kanë qenë, se çfarë ka ndodhë me ta. Tashmë kemi ngritur një Bord të ri në Ndërmarrjen në fjalë dhe është duke funksionuar, i cili ka filluar disa gjëra ti vë nën kontroll dhe do ta forcojmë Ndërmarrjen në fjalë dhe si rrjedhojë do të planifikojmë edhe blerjen e autobusëve të rinj. Gjithashtu sa për njoftim jemi në procedura të themelimit të një ndërmarrjeje të re, në kuadër të saj do të futim në menaxhim edhe këto parkingjet publike që i kemi disa, e nga të cilat nuk kemi bazë ligjore për arkëtimin e të hyrave, sepse kjo bëhet përmes një ndërmarrjeje publike. Besoj se ky trafik urban do të kryej punën si duhet, do të jetë një mundësi për punësim të një numri të rinjve, por do të ketë mundësi për të pasur shërbime edhe më të mira për qytetarët tanë.

**z. Haki Behluli** nga fshati Merdarë, theksoi, kemi infrastrukturë të mirë rrugore dhe janë bërë investime. Desha të theksoj se në fshatin Merdarë jemi diku 15 shtëpi e që pesë(5) vite nuk kemi ujë, e që më parë kemi pas, ndërsa gjendja vështirësohet më tepër kur kemi reshje të mëdha të shiut dhe uji nga pusët bëhet i pa pijshëm. Kërkoj nga autoritetet komunale që të ushtrojë ndikim te KUR "Prishtina" që të na sigurojë ujë të pijshëm. Pra kërkesa është që në ardhmen të sigurohet ndonjë pompë që do të ndihmonte në furnizim të ujit. Ne si komunitet jemi të kënaqur me subvencionim por edhe me kryerje të shërbimeve sikurse kemi të bëjmë me shërbime shëndetësore. Gjithashtu kam një kërkesë për vendosjen e një pengese në një rrugë në fshatin Merdarë. Rruga është në një gjatësi prej 500 m, ndërsa kërkesën në formë të shkruar e kam bërë në vitin 2022. Pengesa ka qenë më herët në atë rrugë por makineritë gjatë pastrimit të borës e kanë larguar nga aty.

**z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, lidhur me diskutimin e parafolësit do të shtoja, çështja e ujit është jetike dhe është një problem që është duke na përcjellë, për të mos thënë se është një problem që e kemi trashëguar, por nuk do të thotë që ne nuk do të merremi me këtë çështje. Sa për njoftim, prej vitit të kaluar kompetencat që kanë të bëjnë me çështjen e ujit komplet janë bartë në nivelin regjional dhe tani për tani asnjë kompetencë dhe asnjë investim si Komunë nuk kemi të drejtë ta bëjmë në këtë aspekt, të gjitha i takojnë KRU "Prishtina". Po mundohem të jap sqarimet se ku qëndron problemi, keni parë që gjatë dy sezoneve verore, së paku sa jam unë kryetar kemi problem në qytet për furnizim me ujë të pijshëm, në veçanti në periudhën kur kemi ardhjen në masë të bashkatdhetarëve. Vitin e kaluar patëm gjetur mirëkuptim me ish Kryeshëfën e KRU "Prishtina" dhe patëm futur një projekt vendosjen e një gypi për furnizim me ujë të pijes. Unë faktikisht nuk jam në dijeni se si ka ndodhë, apo ndoshta edhe ashtu e kanë planifikuar sipas ekspertizës, gypi për furnizim me ujë vjen prej fshatit Shajkoc për furnizim të qytetit të Podujevës deri te lagja e Dëshmorëve dhe është fi 400. Te lagja e cekur i njëjti gyp fi 400 është reduktuar në fi 230 apo 240 ashtu si më është thënë, e kjo është një rast suigeneris, e qysh ka ndodhë nuk jam në dijeni. Ai gyp 230 apo fi 240 e furnizon rezervuarin kryesor të qytetit të Podujevës. Ne gjetëm mirëkuptim sikurse theksova me ish Kryeshëfën e KRU Prishtina dhe jemi duke realizuar projektin, prej lagjes së Kuvajtit me vazhduar me gypin fi 400 deri në rezervuar dhe ky projekt është duke u realizuar. Natën e Bajramit më është dashur të intervenoj edhe pse isha jashtë vendit sepse një pjesë e banorëve të qytetit kishin mbetur pa ujë dhe arsyeja nga ana e



kompanisë ishte se e kanë harxhuar rezervarin sepse po e keqpërdorin ujin. Si Kompani kanë për detyrë që të jenë më të përgjegjshëm dhe të përcjellin furnizimin me ujë edhe ne jemi në dijeni se uji po keqpërdoret, por detyrë e Njesisë është për të menaxhuar të gjitha këto, sepse kanë edhe inspektoratin, e nëse është e nevojshëm i dalim në ndihmë edhe me inspeksionin komunal vetëm me qëllim që të kryhen punët. Dua të theksoj se këtu kemi një ndërmarrje që nuk na jep përgjegjësi, ndërsa nga ana tjetër jemi të varur nga shërbimi i saj dhe qytetari problemin nuk e adreson te ndërmarrja por në Komunë. Të njëjtën gjë kemi me mbeturina. Pra janë dy sektorë që nuk i japin përgjegjësi Komunës, sepse janë ndërmarrje regjionale, por përgjegjësia i bien Kryetarit, drejtorëve edhe pse nuk kanë kurrfarë kompetence. Menaxherët e dy Njësive i japin përgjegjësi Ndërmarrjeve Regjionale. Megjithatë ne kemi vullnetin të investojmë, prapë kemi nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për financimin e një projekti të përbashkët me KRU "Prishtina" sepse është në interes të qytetarëve, por ne nuk mund të jemi bartës të projekteve që realizohen për furnizim, sepse është KRU "Prishtina" si përgjegjëse kryesore regjionale. Pra kemi fshatrat Merdarë, Penuhë, disa lagje të fshatit Konushec që s'kanë fare ujë edhe pse kanë rrjetin e ujësjellësit, kemi lagjen këtu në fshatin Letanc që nuk ka ujë, sepse thuhet se nuk ka shtypje. Kështu që janë probleme që nuk do të kryhen shpejt. Shpresoj nëse kalon fizibiliteti që është duke u bërë për pendën në fshatin Pollatë dhe nëse ec si projekt besoj se në të ardhmen s'do të ketë telashe sa i përket furnizimit me ujë të pijes dhe ndoshta do të ketë edhe ujë mjaftueshëm për ujitje të sipërfaqeve bujqësore, por se a duhet të presim deri sa të realizohet ai projekt, sigurisht që jo, do të bëjmë krejt çka është e mundur me qëllim të përmirësimit të gjendjes. Ne kemi bërë shtrirje të rrjetit të ujësjellësit edhe në fshatin Dumnicë vitin e kaluar, por është e kotë kur s'kemi ujë, e as qyteti nuk është duke u furnizuar mjaftueshëm gjatë verës e mos të flasim për pjesët më periferike, prandaj është shqetësim edhe i yni, nuk është se nuk jemi duke u marrë me të, por është relativisht problematike për të bërë zgjidhje. Besoj se gjendja e furnizimit me ujë do të përmirësohet deri diku pasi që të vihet në funksion gypi fi 400, por nuk do të zgjidhet nevoja e furnizimit me ujë të mjaftueshëm deri sa nuk bëhet një zgjidhje tjetër alternative. Çështje tjetër u theksua pengesa në rrugë, ju më kenë shkruar dhe unë atë kërkesë të juaj e kam përcjellë te Drejtoria e Shërbimeve publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Kemi bërë përpjekje maksimale për t'iu ikur këtyre pengesave, sepse sikurse jeni në dijeni kërkesat për asfaltim të rrugëve janë shumë të mëdha, e në anën tjetër menjëherë pas asfaltimit kërkojnë me vendos pengesa. Unë besoj se disa pika janë kritike dhe duhet të kenë pengesa. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike duhet të dal të shoh atë pikë se a është vërtet e ndjeshme dhe që ka nevojë për pengesë, sepse nuk është problematike vendosja e një pengese. Unë e udhëzoj Drejtorin së bashku pse jo edhe me një inspektor të komunikacionit që nëse vërtetë vlerësohet se ka nevojë për vendosjen e një pengese ajo mund të vendoset. Nuk jemi për të rrezikuar qytetarët, jemi të interesuar për tu krijuar hapësirë dhe lëvizje të sigurt qytetarëve.

Kryetari e përmbylli takimin duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin.

**Mbledhja përfundoi në orën 11.30**

**Procesverbalin e mbajti  
Sabedin Namani**

**Nr.Prot.02-060/04-0044169/23  
Podujevë, datë:30.06.2023**

